



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:022309
Datë: 12.12.2023
Numri i dokumentit: 05051512

C-III-12-1629

Parashtruesi

Prokuroria Themelore Ferizaj (ish- Prokuroria Publike Komunale- Ferizaj)

Kundër

Të paditurat

- Komuna e Ferizajt.**
- NSH “Pasuria Bujqësore“ Ferizaj, përfaqësuar nga *Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.*
- M K**, përfaqësuar nga **M I** avokat nga Ferizaj.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Diellza Hoxha dhe Gazmend Sylaj gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 12 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Dhoma e Posaçme jep pëlqimin për tërheqjen e padisë, ashtu që padia konsiderohet e tërhequr.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 21 shtator 1995, paditësi Prokuroria Komunale në Ferizaj ka parashtruar padi për anulimin e kontratës mbi dhuratën në mes palëve B K dhe Komunës së Ferizajit, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Ferizaj ov.br.4129/60, dt.24 dhjetor 1960.

Me 17 gusht 2012 Gjykata Komunale në Ferizaj, me aktvendimin C.nr. 576/06, është shpallur in kompetente lëndore, për vendosje në lidhje me këtë çështje juridike, dhe lënda i përcillet Dhomës së Posaçme në kompetencë të mëtejme.

Me 21 shtator 2012, lënda u regjistrua në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nën numrin C-III-12-1629.

Me 23 prill 2015, Dhoma e Posaçme lëshon urdhër për AKP-në, përmes se cilit i dërgon padinë dhe dokumentacionin përcjellës të paditurës, më udhëzimin se mund të ushtrojë mbrojtje brenda 1 muaji.

Me 26 maj 2015, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtjen e saj, në të cilën i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij duke i konsideruar si të pabazuara në ligj. E paditura pohon se në bazë të informatave që disponon Zyra Regjionale e AKP-së në Gjilan, ngastra kadastrale ..nuk evidentohet si pronë shoqërore sipas certifikatës së pronës për ZK S dhe njoftimit të kompanisë gjeodezike e kontraktuar nga AL-ja Pasuria Bujqësore për identifikim të pronave shoqërore për ZK S. Lidhur me parcelat të cilat janë objekt i kërkesëpadisë, numrat e këtyre parcelave janë të vjetra, dhe nuk korrespondojnë me numrat e tanishëm të parcelave. Prandaj paditësi duhet ta precizojë padinë dhe të dëshmojë numrat e ngastrave kontestuese të evidentuara tani në kadastrën komunale të KK Ferizaj. Paditësi e mbështet padinë e tij në nenin 103 të LMD, koha kur është lidhur kontrata është viti 1960 ndërsa LMD ka hyrë në fuqi në vitin 1978, çka nënkupton se nuk mund të zbatohen dispozitat e LMD-së në këtë rast, pasi që në bazë të nenit 1106 të LMD-së në mënyrë eksplicite thekson se dispozitat nuk do të zbatohen për obligimet e krijuara para kohës kur ka hyrë në fuqi e që është me 01 tetor 1978. Gjithashtu, paditësi e mbështet padinë në nenin 8a të Ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për qarkullimin e paluajtshmërisë, GZ e RSS nr.28/87, mirëpo ky ligj nuk është i aplikueshëm. Sa i përket presionit AKP-ja konstaton se paditësi nuk ka dëshmuar ndonjë fakt apo ndonjë dëshmi për veprimet e dhunshme të supozuara. Gjithashtu, pretendimi i paditësit për kthim të paluajtshmërisë është jashtë afatit, për faktin se kanë kaluar të gjitha afatet për kërkimin respektivisht kthimin e pronës e të cilat afate janë prekluzive, e që në rastin konkret një pretendim i tillë është parashtruar pas skadimit të afatit pothuajse mbi 40 vite. Në mbështetje të nenit 268 të LPB (Fletorja Zyrtare e RSFJ-së nr.53/76) e paditura e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese, pasi që sendi ka kaluar në pronësi shoqërore dhe kthimi i saj nuk është kërkuar në afat prej 5 vitesh, respektivisht 10 vitesh. Nga kjo shihet se nëse paluajtshmëria kalon në pronë shoqërore edhe pa bazë juridike, kthimi i sendit mund të kërkohet në afat prej 5 vitesh, nga dita e të kuptuarit, e më se voni në afat prej 10 vitesh. Nga padia e parashtruar rezulton së është parashkruar afati i paditësit për të kërkuar kthimin e sendit. Mbi këtë bazë, Kolegji i Specializuar i DHP-së ka refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit në rastin C-III-12-0123. Ndërsa, Paneli i Ankesave i DHP-së e ka refuzuar si të pabazuar ankesën në rastin AC-II-12-0165. Ashtu që, AKP-ja konsideron se pretendimet e paraqitura në padi, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret dhe mungesat e tilla padinë e bëjnë të paqëndrueshme. Andaj, i propozon gjykatës që të hedh poshtë padinë e paditësit si të papranueshme ose të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Në mbështetje të mbrojtës ka bashkangjitur: Vendimin e AKP-së (për fillimin e procedurave të likuidimit) me nr. Ref. BD-53/15 të datës 23 maj 2013 dhe një kopje të dorëzimit të shërbimeve kadastrale në bazë të kontratës nr.... të datëspër ZK S.

Më 06 tetor 2023, gjykata ka lëshuar urdhër për parashtruesin me anë të së cilës i ka dërguar mbrojtjen / përgjigjen e AKP-së në padi të datës 26 maj 2015 së bashku me dokumentacionin përcjellës.

Më 16 tetor 2023, Prokuroria Themelore në Ferizaj, (ish - Prokuroria Publike Komunale në Ferizaj – si inicuese e procedurës) ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e AKP-së, në të cilën thekson se pasi që Prokurori i Shtetit i ka marrë në shikim të gjitha shkresat e bashkangjitura në urdhër dhe në rastin në fjalë e njofton gjykatën se nuk kemi asnjë interes ligjor në këtë çështje civile, si dhe shton se nga të dhënat e bashkangjitura në urdhër, rezulton se prona e cila është objekt i këtij kontesti është pronë e ndërmarrjes NSH Kooperativa Bujqësore, (fleta poseduese e vitit 2015), dhe në këtë rast nuk rezulton se Institucioni i Prokurorit të Shtetit të këtë ndonjë të drejte pronësore mbi parcelat objekt i kësaj çështje civile, andaj propozon që gjykata të veproj në pajtim me dispozitat ligjore për të vendosur për këtë çështje.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit konsiderohet e tërhequr.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Gjykata pajtohet me tërheqjen e padisë, sepse nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë (neni 34.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme).

Neni 34.1 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Paditësi mund ta tërheq kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i serishëm i kërkesës apo ankesës.

Në interpretim të dispozitës së lartcekur, gjykata konstaton se paditësi mund ta tërheq padinë në çdo kohë, nëse nuk është në kundërshtim me interesin e njëjës palë. Në rastin konkret gjykata vlerëson se tërheqja e padisë nga ana e parashtruesit e bërë përmes parashtrësës, është bërë në pajtim me dispozitat ligjore dhe nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë.

Nga kjo, gjykata konsideron se paditësi nuk ka interes për të vazhduar procedurën në këtë çështje juridike dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore padia konsiderohet e tërhequr.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Diellza Hoxha, Gjyqtare

Gazmend Sylaj, Gjyqtar